



Republika Kosova
Republika e Kosovës
Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Klllokot-Vrbovcë

Datë : 29.06.2018.

Në bazë të nenit 12.paragrafi 12.2 (d); nenit 17. Pika (j,m) nenit 43.pika 43.3; nenit 45. Pika 45.1;nenit 46;47,pika:47.2;nenit 48; Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040,si dhe Statutit të Komunës së Klllokot-Vërbovcit nenit 13.pika 13.1.nenit 20.nenit 21.nenit 22.;nenit 23. Kuvendi komunal bjen:

VENDIM

MBI FORMIMIN E KOMISIONIT MBI VËRTETIMIN E GJENDJES MOMENTALE DHE PËRGJEGJËSINË E PERSONELIT PËR BARNAT ME AFAT TË SKADUAR TË VLEFISHMËRISË NË KLLOKOT

Neni 1.

Kuvendi i komunës së Klllokot-Vërbovcit në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit komunal e mbajtur me datë 29.06.2018,në „Shtëpinë e Kulturës „në Klllokot merr vendimin mbi formimin e komisionit mbi vërtetimin e gjendjes momentale dhe përgjegjësinë e personelit për barnat me afat të skaduar të vlefshmërisë në Klllokot.

Neni 2.

Në bazë të propozimit të shefit të kabinetit Momcilo Stojkovic si plotësim i pikave të rendit të ditës është shqyrtuar pika dhe aprovuar vendimi në titull ku është formuar komisioni me votim të hapur nga ana e delegatëve të Kuvendit komunal.

Për votuan 11 delegatë dhe 3 nuk u deklaruan.

Komisionin e përbëjnë anëtarët si vijon::

1. Goran Marinković - drej. Arsim,shëndetësi,shërbime sociale,kulturë,rini dhe sport ;
2. Nenad Rajković - puntor medicinal;
3. Igor Petković – delegat i Kuvendit komunal;
4. Velibor Kostić – delegat i Kuvendit komunal;
5. Shqiprim Rexhepi – delegat i Kuvendit komunal;

Ky komision do të ketë për detyrë të përcaktojë gjendjen faktike në periudhën e përmendur në nenin 3 të këtij vendimi për barnat të cilat e obligojnë infermieren e autorizuar në Qendrën e Mjekësisë Familjare (CPM) në Klllokot të bëjë një listë inventari të të gjitha barnave që janë në magazinë (në dispozicion për përdorim), si dhe barnat të cilat kanë skaduar dhe të lidhura në një raport të shkruar në lidhje me përgjegjësinë e personelit mjekësor për mos shpërndarjen e barnave në emër të recetës për nevojat e pacientëve të cilat ishin tepër të nevojshme për trajtimin e tyre. Kontrollimi i protokollit, librit mbi menaxhimin e ilaçeve të dhëna pacientëve për trajtim nëse ka.

Neni 3.

Kuvendi komunal merr vendimin nga neni 1. Me qëllimin në nenin 2. Që komisioni në afat prej 30 ditësh të implementoj punën nga ky vendim nga dita e marrejs së tij bëhet fjalë për vërtetimin e gjendjes faktike.

Neni 4.

Pas miratimit të këtij Vendimi të Kuvendit për implementimin e tij do të kujdeset komisioni i cekur në vendim,kryetari i komunës dhe drejtoria për arsim,shëndetsi,shërbime sociale,kulturë,rini dhe sport.

Neni 5.

Ky vendim nga neni 1. Hyn në fuqi menjher pas nënshkrimit të tij nga ana e kryesuesit të Kuvendit komunal të Klllokot-Vërbovcit.

Kopja dorëzohet :

- MAPL;
- Kryetarit të Komunës ;
- Antarve të komisionit
- Departamenti për kadastër, urbanizëm dhe gjeodezi
- Kryesuesit të K.K.Klllokot-Vërbovc
- Arkivës komunale

Kryesuesi i Kuvendit komunal
Klllokot-Vërbovc
Zarko Dejanović